

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Qendra e Formimit Profesional Publik _____

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË
“KUJDESTAR SOCIAL”

Kodi: KS-24

Miratoi:

DREJTOR

.....

2024

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“KUJDESTAR SOCIAL”

(KS-24)

I. Profili profesional i kujdestarit social

a) Karakteristikat e kujdestarit social

Kujdestari social është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar apo i vetëpunësuar në mjedise pranë shoqatave, qendrave tranzitore, rezidenciale apo gjysmërezidenciale, qendra të kujdesit ditor, si dhe në shërbime të drejtëpërdrejta në familje me fëmijë, adoleshentë apo të moshuar me probleme të ndryshme psiko-sociale.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të kujdestarit social.

Suksesi i kujdestarit social është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e kujdestarit social

Profesioni i kujdestarit social është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për përkujdesjen ndaj individëve e grupeve vunerabël për mbështetje psiko-sociale në institucione, në mjedise familjare dhe në biznese private.

Ai mund të punësohet në biznese private që ofrojnë shërbime të kujdesit social. Gjithashtu, ai mund të vetëpunësohet si kujdestar social. Me përvojë pune të mëtijshme dhe kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e shërbimeve që jep, kujdestari social mund të krijojë biznesin e tij në këtë sektor dhe të krijojë mundësi punësimi për të tjerë.

Ndjekja e shkollës së lartë për “Punë Sociale”, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e punonjësit social.

Për të zhvilluar aktivitetet privat dhe për vetëpunësim, në veprimtarinë e kujdestarit social duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësitë “Kujdestar social” me kod 3412.03 referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Kujdestar social”

Në përfundim të Kursit për “Kujdestar social”, kursantët do të jenë të aftë të:

- identifikojnë rolin dhe rëndësinë e përfshirjes në shërbime sociale individuale dhe në target-grupe, pranë familjeve dhe qendrave sociale;
- përmbushin nevojat psiko-sociale të fëmijëve, adoleshentëve dhe të moshuarve;
- përcaktojnë rolin dhe detyrat e tij në këtë proces;
- menaxhojnë drejtpërdrejt planet e përkujdesjes psiko-sociale për fëmijët, adoleshentët dhe të moshuarit;

- asistojnë në trajtimin e fëmijëve, adoleshentëve dhe të moshuarve vulnerabël dhe programet e edukimit;
- zbatojnë planin e kujdesit;
- vlerësojnë nevojat personale (fëmijë, adoleshentë, të moshuar);
- të bashkëpunojnë në mënyrë profesionale me individin dhe familjen e tij;
- asistojnë dhe orientojnë veprimtarinë e vetëshërbimit;
- respektojnë të drejtat dhe dinjitetin e personave me të cilët punon;
- përvetësojnë teknikat në zbatimin e planeve të punës me target-grupe;
- organizojnë aktivitete edukative, sociale dhe kreative për fëmijët e grupmoshave të ndryshme, adoleshentët dhe të moshuarit;
- të zbatojnë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojnë rregullat e komunikimit me etikë profesionale.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Kujdestar social”

Pjesëmarrësit në Kursin për “Kujdestar social” duhet të jenë mbi 18 vjeç, si dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Udhërrëfim turistik”

260 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Kujdestar social”

Nr.	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionine kujdestarit social	KS -01-24	50 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kujdestarit social. 2. Kursanti përshkruan rolin dhe rëndësinë e shërbimeve sociale. 3. Kursanti përcakton rolin dhe detyrat e kujdestarit social.
2	Përkujdesje psiko-sociale te fëmijët	KS-02-24	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti identifikon mjedisin që ofron mbështetje psiko- sociale te fëmijët. 2. Kursanti zbaton Konventën e të drejtave të fëmijëve. 3. Kursanti zbaton planin e punës me parashkollorët. 4. Kursanti asiston trajtimin e fëmijëve vulnerabël.

3	Përkujdesje psiko-sociale te adoleshentët	KS-03-24	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan procesin e zhvillimit të adoleshentët. 2. Kursanti vlerëson rëndësinë e ndihmës ndaj adoleshentëve. 3. Kursanti asiston në nevojat e adoleshentëve.
4	Përkujdesje psiko-sociale te të moshuarit	KS - 04-24	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan procesin e përkujdesjes te të moshuarit. 2. Kursanti vlerëson nevojat e të moshuarve. 3. Kursanti harton e planin e kujdesit për të moshuarit. 4. Kursanti zbaton planin e punës për përkujdesjen e të moshuarve. 5. Kursanti kujdeset për gjendjen psiko-sociale të të moshuarve. 6. Kursanti asiston trajtimin e të moshuarve vulnerabël.

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit (RN-të) që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse, që njihet nga MEKI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Kujdestar social”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e kujdestarit social”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E KUJDESTARIT SOCIAL	KS-01-24
Qëllimi i modulit	Një modul teorik, që njeh kursantët me mjedisin e punës, veçoritë dhe kërkesat e profesionit të kujdestarit social, përcaktimin e rolit të tij gjatë përfshirjes në shërbimet sociale, familjare, komunitare dhe zbatimin e etikës profesionale për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të kujdestarit social. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e kujdestarit social; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës; - të përshkruajë mjedisin, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës; - të përshkruajë proceset bazë të veprimtarisë së kujdestarit social; - të përshkruajë marrëdhënien e kujdestarit social me individët që kanë nevojë; - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë së kujdestarit social; - të përshkruajë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë; - të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë - Pyetje-përgjigje me shkrim	
	RN 2 Kursanti përshkruan rolin dhe rëndësinë e shërbimeve sociale. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë qëllimin e shërbimeve sociale;	

- të përshkruajë vendet në të cilat kryhen shërbime sociale;
- të evidentojë llojet e shërbimeve sociale;
- të përshkruajë llojet e shërbimeve sociale;
- të analizojë vlerat e shërbimeve sociale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Pyetje-përgjigje me shkrim

RN 3 Kursanti përcakton rolin dhe detyrat e kujdestarit social.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë rolin dhe detyrat e kujdestarit social;
- të evidentojë sektorët e aktivitetit të veprimit të kujdestarit social;
- të zbatojë parimet e etikës së kujdestarit social;
- të zbatojë rregullat për dëgjimin empatik;
- të analizojë komunikimin dhe sjelljen veti dhe të tjetrit;
- të menaxhojë procesin e trajtimit të problemit të tjetrit;
- të respektojë diversitetin e individëve, me të cilët punon;
- të ruajë konfidencialitetin e të dhënave të personave, me të cilët punon.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjedis të punës. Atyre duhet t'u jepen detyra si: të përshkruajnë veçoritë e profesionit të kujdestarit social, detyrat e kujdestarit social.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës.
 - Komplet i materialeve, paisjeve dhe instrumenteve të punës.

2. Moduli “Përkujdesje psiko-sociale për fëmijët”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJE PSIKO-SOCIALE PËR FËMIJËT	KS-02-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që aftëson kursantët për të kryer hartimin, zbatimin e planit të kujdesit psiko-social të fëmijëve në punën individuale ose në grup në përshtatshmëri me nevojat e tyre.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e kujdestarit social”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti identifikon mjedisin që ofron përkujdesje psiko-sociale për fëmijët. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë mjedisin që ofron mbështetje psiko-sociale të fëmijët; - të identifikojë karakteristikat e përgjithshme të zhvillimit të fëmijëve; - të përshkruajë karakteristikat e fëmijëve me rrezik abuzimi; - të analizojë rolin e kujdestarit social gjatë punës me fëmijë; - të zbatojë rregullat e higjenës dhe të sigurisë në ambientin ku ofrohet shërbimi. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RN 2 Kursanti zbaton Konventën e të drejtave të fëmijëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë Konventën e të drejtave të fëmijëve; - të zbatojë parimet e Konventës së të drejtave të fëmijëve; - të tregojë veçoritë e punës me individë dhe në grup; - të bashkëpunojë me prindërit e fëmijëve; - të ruajë konfidencialitetin gjatë punës me fëmijët; - të ruajë të drejtat e fëmijëve të kulturave të tjera. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli	

RN 3 Kursanti zbaton planin e punës me parashkollorët.***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë rezultatet e vëzhgimit të parashkollorëve;
- të realizojë veprimtarinë edukative me parashkollorët për botën që i rrethon;
- të zbatojë të drejtën për të trajtuar parashkollorët me seriozitet;
- të trajtojë probleme të parashkollorëve;
- të realizojë veprimtari me të folurin dhe shprehurin;
- të zbatojë teknikat e komunikimit me fëmijët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Kursanti asiston trajtimin e fëmijëve vulnerabël.***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mënyrat e trajtimit të fëmijëve vulnerabël;
- të përcaktojë kategoritë e fëmijëve vulnerabël;
- të vlerësojë nevojat e fëmijëve vulnerabël;
- të zbatojë strategjitë social-komunitare për parandalimin e dhunës së fëmijëve;
- të zbatojë strategjitë social-komunitare për parandalimin e bullizmit;
- të zbatojë strategjitë social-komunitare për parandalimin e abuzimit;
- të përdorë teknikat të njohjes me fëmijët;
- të asistojë në mbështetjen psiko-sociale të fëmijëve vulnerabël;
- të kryejë punë në qendrat e shërbimit social;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojë etikën profesionale në komunikim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të kujdesit social.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra si: zbatimi i aktivitetit të trajtimit psiko-social dhe zbatimi i planit të përkujdesit të fëmijëve.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.

-
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul, detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. Rekomandohet përdorimi i metodave të simulimit dhe të lojës me role.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit, të specifikuara për çdo rezultat të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Përkujdesje psiko-sociale te adoleshentët”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJE PSIKO-SOCIALE TE ADOLESHENTËT	KS-03-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që aftëson kursantët të ofrojnë shërbim dhe mbështetje ndaj adoleshentëve me probleme psiko-sociale.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përfunduar modulet: “Hyrtje në profesionin e kujdestarit social”, “Përkujdesje psiko-sociale te fëmijët”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan procesin e zhvillimit të adoleshentët. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë fazën e adoleshencës; - të evidentojë zhvillimet kryesore në adoleshencë; - të identifikojë zhvillimet kryesore në adoleshencë; - të përcaktojë faktorët social në zhvillimin e adoleshencës; - të përcaktojë faktorët individual në zhvillimin e adoleshencës; - të indentifikojë faktorët nxitës dhe pengues të zhvillimit social të adoleshentëve. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim RN 2 Kursanti vlerëson rëndësinë e ndihmës ndaj adoleshentëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë problematikat e adoleshentëve; - të evidentojë burimet e konflikteve të adoleshentët; - të vlerësojë marrëdhëniet shoqërore mes adoleshentëve; - të nxitë marrëdhëniet adoleshent-prind; - të këshillojë adoleshentët për efektet e përdorimit të drogës, alkolit dhe duhanit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RN 3 Kursanti asiston në nevojat e adoleshentëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përcaktojë problematikat e adoleshentëve;	

- të evidentojë burimet e konflikteve te adoleshentët;
- të vendosë kontakte me adoleshentët;
- të orientojë vendosjen e marrëdhënieve shoqërore mes adoleshentëve;
- të orientojë adoleshentët në vendosjen e marrëdhënieve me prindërit;
- të organizojë takime informuese për përdorimin e drogës dhe alkolit;
- të organizojë takime informuese për përdorimin e duhanit te adoleshentët;
- të ndërmjetësojë raste, situata të ndryshme duke u bazuar te nevojat e adoleshentëve;
- të evidentojë burimet e konflikteve te adoleshentët;
- të vlerësojë marrëdhëniet shoqërore mes adoleshentëve;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojë etikën profesionale në komunikim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Kursanti asiston trajtimin e adoleshentëve vulnerabël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë kategoritë e adoleshentëve vulnerabël;
- të vlerësojë nevojat e adoleshentëve vulnerabël;
- të zbatojë strategjitë social-komunitare për parandalimin e problematikave të adoleshentëve vulnerabël;
- të përdorë teknikat e njohjes me adoleshentët vulnerabël;
- të asistojë në mbështetjen psiko-sociale të adoleshentëve vulnerabël;
- të kryejë punë në mjediset e qendrave përkatëse;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojë etikën profesionale në komunikim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të kujdesit social.

- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. Atyre duhet t'u jepen detyra të tilla si: të asistojnë në nevojat e adoleshentëve, të përcaktojnë problematikat e adoleshentëve.
- Kursantët të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që

	kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Kompleti i materialeve, paisjeve dhe instrumenteve të punës.

4. Moduli “Përkujdesje psiko-sociale te të moshuarit”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PËRKUJDESJE PSIKO-SOCIALE TE TË MOSHUARIT	KS-04-24
Qëllimi i modulit	Një modul praktik, që aftëson kursantët për zbatimin e planit të shëndetit, kujdesin për jetën sociale, autonominë e zgjedhjes, vetëshërbimit të të moshuarve pranë familjeve, qendrave ditore dhe rezidenciale për të moshuarit.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përfunduar modulet: “Hyrje në profesionin e kujdestarit social”, “Përkujdesje psiko-sociale te fëmijët ” dhe “Përkujdesje psiko-sociale te adoleshentët”.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti pëshkruan procesin e përkujdesit te të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë procesin e kujdesjes geriatrike; - të evidentojë ndryshimet gjatë moshës së pleqërisë; - të përcaktojë faktorët biologjikë; - të analizojë ndryshimet sociale në moshën e tretë; - të përcaktojë përkujdesjen sipas rasteve përkatëse. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë - Pyetje-përgjigje me shkrim RN 2 Kursanti vlerëson nevojat e të moshuarve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të vlerësojë nevojat jetësore të të moshuarve; - të trajtojë nevojat për autonomi; - të menaxhojë situatat e inaktivitetit fizik; - të kryejë vrojtimin e lirë dhe sistematik të të moshuarit; - të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë; - të zbatojë etikën profesionale në komunikim. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RN 3 Kursanti harton e planin e kujdesit për të moshuarit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të vlerësojë nevojat sociale te të moshuarit;	

- të vlerësojë nevojat shëndetësore të të moshuarit;
- të hartojë planin e punës për nevojat sociale të të moshuarit;
- të hartojë planin e punës për nevojat shëndetësore të të moshuarit;
- të përpilojë raportin mbi gjendjen aktuale të të moshuarve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 4 Kursanti zbaton planin e punës për përkujdesjen e të moshuarve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bashkëpunojë me të moshuarit;
- të bashkëpunojë me familjarët e të moshuarve;
- të zbatojë etikën e komunikimit në grup;
- të kryejë shoqërimin e të moshuarve;
- të kryejë shërbimin social shëndetësor;
- të japë ndihmën e parë të të moshuarit;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojë etikën profesionale në komunikim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 5 Kursanti kujdeset për gjendjen psiko-sociale të të moshuarve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përkujdeset për gjendjen psiko-sociale të të moshuarve;
- të sigurojë një rutinë të shëndetshme në ambientin ku jetojnë të moshuarit;
- të realizojë komunikim efektiv me qëllim rëfimtarinë;
- të inkurajojë të moshuarit gjatë procesit të dhimbjes;
- të inkurajojë të moshuarit gjatë procesit të humbjes;
- të inkurajojë të moshuarit gjatë procesit të braktisjes;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojë etikën profesionale në komunikim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 6 Kursanti asiston trajtimin e të moshuarve vulnerabël.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë kategoritë e të moshuarve vulnerabël;
- të vlerësojë nevojat e të moshuarve vulnerabël;
- të zbatojë strategjitë social-komunitare për parandalimin

e problemeve të të moshuarve;

- të përdorë teknikat e njohjes me të moshuarit;
- të asistojë në mbështetjen psiko-sociale të moshuarve vulnerabël;
- të kryejë punë në qendrat e kujdesit për të moshuarit;
- të zbatojë rregullat e higjienës dhe sigurisë në punë;
- të zbatojë etikën profesionale në komunikim.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore. Rekomandohen vizita dhe praktika në bizneset ku ofrohen shërbime të kujdesit social. - Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës. - Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të nxënit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedisë dhe materialet e nevojshme për garantimin shërbimit. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.